




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKI I KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. DPKI
 Dep. _____
 Nr. i faq. _____
 Broj stranica 02

Nr. Prot. _____
 Br. Prot. _____
 Prot. No. 06-78/20
 Data _____
 Datum 20.01.2020

REPUBLIC OF KOSOVO
 REPUBLIKA E KOSOVES
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.01.2020, mori:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI- 01/19/030*, për zyrtarin e lartë z. Aziz Bici, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Obiliqit, për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli *AKK-DPKI-01/19/030*, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Aziz Bici, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Obiliqit, është zhvilluar procedura e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia), sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konflikt të interesit sipas të cilit z. Aziz Bici, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Obiliqit, i njëjti figuronte si Person i Autorizuar në biznesin privat "Aziz Bici" B.I. Me shkresën zyrtare DPKI-06-01/2337/19, Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (në tekstin e mëtutjeshëm: ARBK), verifikimin dhe konfirmimin e informacionit lidhur me biznesin e cituar mësipër. Nga përgjigja e ARBK-së (shkresa zyrtare nr. DPKI-06-2337-1/19), rezulton se zyrtari i lartë z. Aziz Bici është pronar dhe person i autorizuar në biznesin në fjalë.



Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm se zyrtari i lartë është njëkohësisht edhe Person i Autorizuar në biznesin privat, Agjencia në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkzionit Publik, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Azizi Bici për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-01/19/030, dhe se në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese, ai ka të drejtë të njoftohet gjerësisht me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin në fjalë.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga pala, me kërkesë të tij është organizuar dhe mbajtur një takim brenda Agjencisë, ku zyrtari i lartë është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, gjatë ushtrimit të funksionit në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të jetë edhe Person i Autorizuar në biznesin privat, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, situatë e cila është në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkzionit Publik, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Aziz Bici është pajtuar tërësisht me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-2534-1/19), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Aziz Bici nuk figuron më të jetë Person i Autorizuar dhe as pronar i biznesit privat “Aziz Bici” B.I, sepse biznesi në fjalë tashmë është shuar.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Aziz Bici, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Obiliqit, duke u tërhequr nga pozita e Personit të Autorizuar në biznes, përkatësisht shuarja e biznesit në fjalë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

